

VENDIM
Nr. 164, datë 18.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 200, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË MIRDITË DHE KAMZË, DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 200, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, shifra “... 466 930 089 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë, pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 746 547 342 (shtatëqind e dyzet e gjashtë milionë e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH ...”.

b) Në shkronjën “b”, të pikës 1, shifra “... 364 210 000 (treqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e dyqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 643 827 253 (gjashtëqind e dyzet e tre milionë e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ...”.

c) Pas nënndarjes “ii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, shtohet nënndarja “iii”, me këtë përmbajtje:

“iii. rikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare “Azem Hajdari”, Zall Mner, Bashkia Kamzë, në masën 279 617 253 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.”.

ç) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë për rikonstrukcionin e objekteve arsimore, në masën 162 543 450 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e pesëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për rikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare “Azem Hajdari”, Zall Mner, Bashkia Kamzë, fondi, në masën 55 923 450 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Për rikonstrukcionin e gjimnazit “Isa Boletini”, fondi në masën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

c) Për rikonstrukcionin e kopshtit Zall Mner, fondi në masën 56 620 000 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama